



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER MIMOZA XHAFAJ
ADRESA NJESIA ADMINISTRATIVE
NR. 9, RR. IBRAHIM RUGOVA,
GODINA SKY TOWER
TEL: 0682066800

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 975

Nr. koleksioni: 202

Tirane më 25/07/2022

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

*Akti noterial përbëhet nga 4 fletë



A2022054080020662256



A202205408002062256

KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI
(TË SHOQËRISË "RTV ADRIA-MED" SH.P.K)

Sot, në datë 25.07.2022 (dymijë e njëzet e dy), përpara meje Notere Mimosë XHAFJAJ, Anëtare e Dhomës Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore Tiranë, me Zyrë në Pallatin Sky Tower, kati I-të, Rruga "Ibrahim RUGOVA", nr. 5, Tiranë, u paraqitën personalisht Palët e interesuara si më poshtë:

PALA SHITËSE: **Z. Gentian FERHATI**, i biri i Bashkim dhe Myrvete, i datëlindjes 04.06.1978, lindur në Shkodër dhe banues në adresën: Rr. "R.Petrela"; Nd. 061; Ap. 00; Njësia Administrative Nr. 9; Tiranë, i identifikuar me Letërnjoftimin me Nr. Personal H80604079N, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar

(më poshtë i quajtur "Shitësi");

Znj. Egesta FERHATI, e bija e Gëzim dhe Fatmire, e datëlindjes 26.07.1984, lindur në Shkodër dhe banuese në adresën: Rr. "R.Petrela"; Nd. 061; Ap. 00; Njësia Administrative Nr. 9; Tiranë, e identifikuar me Letërnjoftimin me Nr. Personal I45726104E, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar

(këtu e më poshtë quajtur "Bashkëshortja")

Dhe

PALA BLERËSE: **Z. Enver MEHMETI**, i biri i Skenderit dhe Aishe, i datëlindjes 22.08.1962, lindur në Durrës dhe banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar me Letërnjoftimin Nr. Personal G20822071P.

(më poshtë i quajtur "Blerësi").

BAZA LIGJORE : Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 705 dhe vijues të tij; Ligji 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"; Ligji nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë".

Shitësi dhe Blerësi, të cilët referohen bashkërisht si "Palët" dhe individualisht si "Pala".

NDERSA

- I. "RTV ADRIA-MED" shpk, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar më 27.09.2010 dhe regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, Shqipëri më dt. 12.10.2010, me seli në Rruga "Shyqyri Bërxolli", Njësia Bashkiake Nr. 10; Ambient Shërbimi Nr. 28; Seksioni B; Akset D-H dhe 1-3, Kati +1, Tiranë, Shqipëri, me Numër Unik të Identifikimit të subjektit L02212502M, me kapital të regjistruar prej 650 000 (gjashtëqind e pesëdhjetëmijë) lekë, i ndarë në 2 (dy) kuota.



A2022054080020662256

ii. Shitësi do t'i shesë Blerësit 1 (një) pjesë / kuotë të zotëruara prej Shitësit që përfaqëson 60 % (gjashtëdhjetë përqind) të Kapitalit të Shoqërisë dhe Blerësi do të blejë 1 (një) pjesë / kuotë të zotëruara prej Shitësit që përfaqëson 60 % (gjashtëdhjetë përqind) të Kapitalit të Shoqërisë;

ATEHERE, palët, në përputhje me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve Nr. Extra, datë 30.06.2022, bien dakord sa më poshtë:

Neni 1 Objekti

Shitësi bie dakord t'i shesë Blerësit dhe Blerësi bie dakord të blejë nga Shitësi 1 (një) pjesë / kuotë të tij në Shoqërinë "RTV ADRIA-MED" sh.p.k., e cila përfaqëson 60 % (gjashtëdhjetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë ("Kuota").

Neni 2 Çmimi i kuotës

2.1 Palët bien dakord se çmimi i pjesës / kuotës është 390 000 (treqind e nëntëdhjetë) Lekë vlerë e cila do të paguhet në bankë nga blerësi, në llogarinë personale të z. Gentina Ferhati dhe mandatet bankare do ti bashkëlidhen kësaj Kontrate, si provë. Shitësi nuk ka më asnjë pretendim në lidhje me pagesën.

Neni 3 Transferimi i kuotës

3.1 Të drejtat pronësisë të Shitësit mbi kuotat e zotëruara në Shoqërinë "RTV ADRIA-MED" sh.p.k. do t'i transferohen Blerësit menjëherë me nënshkrimin e kësaj Kontrate.
3.2. Transferimi do të ndodhë menjëherë me nënshkrimin e kësaj Kontrate.

Neni 4 Përfaqësime dhe garanci

4.1 Njëpërmjet kësaj Kontrate, Shitësi përfaqëson dhe i garanton Blerësin se:
i. Shitësi është zotëruari i ligjshëm i 1 (një) pjesë / kuotat në Shoqërinë "RTV ADRIA-MED" sh.p.k., e cila përfaqëson 60 % (gjashtëdhjetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë ("Kuota") dhe nuk ka pretendime nga ndonjë palë e tretë mbi të drejtat e pronësisë të Kuotës, të tashme apo potenciale, e cila mund të ketë një impakt material mbi të drejtën e pronësisë së Kuotës.
ii. Shitësi dhe Blerësi nuk po shkel ndonjë marrëveshje në të cilën paraqitet si palë, e cila mund të ndikojë negativisht në blerjen e Kuotës;
iii. Kuota nuk i nënshtrohet ndonjë kufizimi apo barre në favor të ndonjë palë të tretë.
4.2 Secila prej palëve kontraktore përfaqëson dhe garanton se, ka aftësinë ligjore të nënshkruajë këtë Kontrate dhe të gjitha kushtet dhe afatet të kësaj Kontrate janë të detyrueshme për tu zbatuar prej tyre.

Neni 5 Taksat e aplikueshme

5.1 Të gjitha taksat, tarifat dhe detyrimet e një natyre tjetër, të tashme dhe/ose të mëvonshme në lidhje me nënshkrimin dhe regjistrimin e kësaj Kontrate do të paguhet sipas ligjit.



A2022054080020662256

Neni 6

Të ndryshme

6.1 Mos ekzekutimi nga ndonjëra prej palëve të ndonjë të drejte në lidhje me këtë Kontratë nuk do të interpretohet si heqje dorë nga kjo e drejtë. Në asnjë rast veprimet ose mosveprimet e ndonjëres prej palëve, me përjashtim të rastit kur pala heq dorë në mënyrë të shprehur me shkrim, nuk do të përbëjnë heqje dorë nga kjo palë nga të drejtat e lindura nga shkelja e Kontratës në tërësi apo të ndonjë dispozite të saj në veçanti. Nëse ndonjë palë heq dorë nga të drejtat e lindura nga shkelja e ndonjë dispozite të Kontratës nga ana e palës tjetër, në një apo më shumë raste, nuk do të konsiderohet si heqje dorë nga të drejtat e saj në rast të shkeljes së mëpasshme të po së njëjtës dispozite, apo si heqje dorë nga zbatimi i dispozitës së shkelur.

6.2 Kjo Kontratë përbën marrëveshjen dhe mirëkuptimin e plotë midis palëve në lidhje me objektin e kësaj marrëveshjeje dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet dhe mirëkuptimet e mëparshme, në formë të shkruar dhe verbale, midis palëve nënshkruese. Nuk ka deklarim, premtim, deklaratë ose qëllim në formë të shkruar ose verbale, midis palëve që nuk është përfshirë në këtë Kontratë që mund të kenë pasojë ose efekt mbi Kontratën ose objektin e saj.

6.3 Palët deklarojnë dhe pranojnë se, z. Gentian FERHATI, në cilësinë e palës shitëse, nuk ka asnjë detyrim ligjor, ndaj shtetit dhe të tretëve, nga momenti i blerjes nga ana e tij të Kuotave të shoqërisë dhe deri në ditën e nënshkrimit të kësaj Kontrate.

6.4 Kjo Kontratë nuk do të ndryshohet, zëvendësohet ose anulohet përveç se me një dokument në formë shkresore të nënshkruar nga të dyja palët dhe çdo dokument që ka për qëllim të ndryshojë, zëvendësojë ose anulojë Kontratën ose pjesë të saj nuk do të jetë i detyrueshëm dhe nuk do të ketë efekt deri në momentin që nënshkruhet dhe dorëzohet nga të dyja palët.

6.5 Nëse ndonjë nga nenet e Kontratës shpallet e pavlefshme ose e pazbatueshme, vlefshmëria ose zbatueshmëria e neneve të tjera nuk do të ndikohet. Neni i pavlefshëm do të zëvendësohet nga një i vlefshëm i cili i korrespondon sa më shumë të jetë e mundur qëllimit të palëve.

6.6 Në këtë Kontratë, përveç kur konteksti e kërkon ndryshe fjalët në njëjës do të përfshijnë edhe fjalët në shumës dhe e anasjelltas, fjalët që përfaqësojnë një gjini do të përfshijnë edhe gjininë tjetër. Gjuha e kësaj Kontrate në të gjitha rastet do të interpretohet si një e tërë në përputhje me kuptimin e saj të drejtë dhe pa nënkuptuar supozime se kushtet në të duhet të interpretohet më rreptësisht kundër njëres Palë në krahasim me Palën që ka përgatitur të njëjtën gjë; bëhet me dije se të dyja Palët kanë marrë pjesë në hartimin dhe negocimin e kësaj Kontrate.

6.7 Kjo Kontratë do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me Ligjet e Republikës së Shqipërisë.

6.8 Kësaj kontrate i bashkëlidhen si pjesë përbërëse dhe të pandarë këto dokumente që do të quhen Aneksë të Kontratës;

- Vendimi i Asamblesë së Ortakëve me nr. Extra 01/2022, datë 25.07.2022, bashkëlidhur Vërtetim nënshkrimi nr. 973 Rep, datë 25.07.2022, Notere Mimoza XHAFAJ;
- Ekstrakt i Regjistrimit Tregtar për Shoqërinë "RTV ADRIA-MED" Sh.p.k.;
- Informacioni i marrë nga Regjistri i Barrëve Siguruese, Tiranë;
- Certifikatë familjare e palës Shitëse;
- Dokumentet e identifikimit të palëve kontraktuese.

Neni 7

Dhënia e Pëlqimit nga Bashkëshortja



A2022054080020662256

Në bazë të parashikimeve të Ligjit Nr.9062, datë 08.05.2003 “Kodi i Familjes” lidhur me miratimin e bashkësisë ligjore, Bashkëshortja e Shitësit, miraton përmbajtjen e kësaj Kontrate lidhur me transferimin e pronësisë së Kuotës nga Shitësi të Blerësi dhe për rrjedhojë deklaron se nuk ka asnjë pretendim, të tashëm apo të ardhshëm, në lidhje me objektin e kësaj Kontrate.

Unë, Noterja deklaroj se mora pëlqimin e Palëve për përdorimin e të dhënave personale. Këto të dhëna janë konfidenciale dhe u përdorën vetëm për krijimin dhe redaktimin e këtij Akti, në zbatim të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.

Unë, Noterja, hartova këtë Kontratë në 4 (katër) kopje origjinale, në gjuhën shqipe. Nga ana ime Kontrata iu lexua Palëve Pjesëmarrëse. Të dyja Palët deklaruan para meje se Kontrata është konform vullnetit të tyre të lirë dhe të pavesuar dhe në shenjë pranimi e nënshkruan atë në praninë time. Unë, Noterja legalizoj vullnetin e tyre sipas Ligjit.

PALËT NË KONTRATË

PALA SHITËSE
Gentian FERHATI

Gentian Ferhati

PALA BLERËSE
Enver MEHMETI

ENVER MEHMETI

DHENESE E PELQIMIT
Bashkëshortja e Shitësit
Egesta FERHATI

Egesta Ferhati

[Signature]

NOTERE
MIMOZA XHAFAJ



Mimoza Xhafaj

[Signature]

